
 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	<b>KUVENDI I KOMUNËS          SKUPŠTINA OPŠTINE          MUNICIPAL ASSEMBLY</b>		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	00 Nr.99 /2022	Data: 29.06.2022	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe neni 40 paragrafi 40.2 pika e) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe në pajtim me nenin 33. Paragrafi 33.1. pika 5) të Statutit të Komunës 01 Numër 62/10, nenit 18 nenparagrafi 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 si dhe neni 20 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale. Neni 18 dhe neni 21 paragrafi 5 dhe 6 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, në mbledhjen e mbajtur më: 29.06.2022, mori këtë:

### V E N D I M

#### FORMIMI I KOMISIONIT PËR ANKESA NDAJ DHËNIES NE SHFRYTËZIM TË PRONËS SE PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Formohet komisioni për ankesa ndajë dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, dhe mandati i këtij komisioni është 2 (dy) vjeç brenda mandatit të Kuvendit.
  2. Ky komision përbëhet nga këta anëtarët:
    1. z. Haki Podrimaj nga radhët e LDK-së Kryesues,
    2. z. Nexhdet Ramaj, nga radhët e AAK-së, anëtar,
    3. z. Kushtrim Buleshkaj, Drejtor i Inspeksionit, anëtar,
    4. z. Gazmend Sadrijaj, zyrtar ligjor 1, anëtar,
    5. z. Fabian Ferizaj, nga shoqëria civile anëtar.
  3. Komisioni i cekur me lartë do të bëjë shqyrtimin e të gjitha ankesave brenda dhjetë ditëve, ku do t'i kryejë punët dhe detyrat të tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni, komisionit në pajtim me Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat të tjera të cilat janë në natyrën e komisionit.
  4. Të gjitha punët administrativo-juridike dhe përkrahjen për Komisionin do t'i kryejë Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi. Ashtu siç është paraparë në nenin 18 paragrafi 5 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale.
  5. Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjete) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi.
- Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, MAPL, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.


  
 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT  
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK  
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE  
 Urales-Izlazna

**Kryesuesi i Kuvendit,**  
**z. Enver Rugova**

Nr: -51-039      Data 5.07.2022  
 Br:                      Datum

ISTOG-ISTOK